



Albania  
Investment  
Council

Improving Transparency and Investment Climate

**GJETJET E VROJTIMIT  
MBI  
DISA ASPEKTE TË KLIMËS SË INVESTIMEVE**

**SEKRETARIATI I KËSHILLIT TË INVESTIMEVE**

**TETOR 2017**

# Përmbajtja e Prezantimit të Vrojtimit

---

- ▶ I. Hyrje
  - ▶ II. Profili i Bizneseve të Përgjigjura
  - ▶ III. Gjetje mbi :
    - ▶ Kontrolli Tatimor
    - ▶ Rimbursimi i TVSH-së
    - ▶ Marrëdhëniet me Administratën Tatimore
    - ▶ Informaliteti
    - ▶ Klima e Biznesit
  - ▶ VI. Përmbledhje e Komenteve dhe Sugjerimeve të Bizneseve
  - ▶ V. Rekomandime dhe Konkluzione
- 



# I. Hyrje

## ► Objektivi i Vrojtimet:

- Evidentimi i ecures së shqetësimeve kryesore të biznesit mbi disa aspekte të klimës së investimeve me fokus :
  - a. Inspektimin Tatimor dhe Marrëdhëniet me Administratën Tatimore
  - b. Informaliteti
  - c. Rimbursimin e TVSH-së
- Krahësimin e disa prej gjetjeve me vërtetimet e mëparshme të Sekretariatit mbi këto çështje.


## ► Metoda:

- Pyetësorë të plotësuar rastësisht online në mënyrë anonime nga 146 biznese
- Pyetësor gjysëm i strukturuar
- Publikuar në Shqip dhe Anglisht në faqen e internetit të KI dhe Universitetit EPOKA (Korrik-Shtator 2017), dhe link reklamuar në rrjetet sociale përkatëse (FB, TëT)
- Dërguar link me e-mail në rreth 8000 adresa biznesi marrë nga QKB, DPT, Universiteti EPOKA, kontaktuar me telefon rreth 1000 biznese.
- Bashkëpunim me EPOKA për sensibilizim biznesesh, asistencë në përpunim statistikor dhe certifikim të dhënash.




## II. Profili i Bizneseve të Përgjigjura


Sektorët Përfaqësues në Vrojtim



Madhësia e biznesit




Pronesia




## II. Profili i Bizneseve të Përgjigjura -Eksportues


A jeni biznes eksportues?



Profili i eksportuesve





# III. Kontrolli Tatimor – Llojet dhe Frekuenca e Kontrolleve Tatimore ( 2013-2016)



**Britje e lehtë e numrit të kontrolleve gjatë 2016, kryesisht vizita fiskale dhe inspektime në terren.**



# III. Kontrolli Tatimor – sipas Madhësisë së Biznesit dhe Sektorit




Biznesi mbi 8 million lekë ka përjetuar rritje të numrit kontrolleve në 2016, ndërkohë që sektori me numrin më të lartë sidomos të inspektimeve në terren paraqitet Tregtia.




## III. Kontrolli Tatimor – Sektori Shërbime dhe Industri

Sherbime





Industria Perpunues



Shërbimet kanë patur **numër të lartë kontrollesh**, si në vizita fiskale dhe inspektime në terren, në dallim nga sektori i industrisë përpunuese ku raportohet një **rënie te theksuar** të tyre. Kjo tendencë e kontrolleve ndoshta është në linjë dhe me **politikën e riskut të deklaruar nga AT**.





# III. Kontrolli Tatimor – Profesionalizmi i Inspektorit Tatimor (2017)



Ka një vlerësim mbizotërues “professional” në agregatin e tërë kriterëve. Kriteri që është vlerësuar më pak dhe është dallues si “jo professional” mbetet “mbështetja logjistike”. Sjellja/etika dhe komunikimi janë ndër elementët e profesionalizimit të vlerësuar më pozitivisht.

# III. Kontrolli Tatimor – Profesionalizmi i Inspektorit

## Tatimor: Vlerësim krahashues 2015 - 2017




**Shënim:** rezultatet e t-test mbi ndryshimin midis të dhënave për dy vite tregojnë një nivel sinjifikance në 5%

Ka një rritje të dukshme të vlerësimit “professional” në marrëdhëniet e biznesit me inspektorin tatimor, sidomos përsa i përket **komunikimit dhe etikës**.




# III. Kontrolli Tatimor – Vlerësim krahasues mbi Inspektorin Tatimor

Kompetencat Profesionale




Mbeshtetja Logjistike



**Shënim:** rezultatet e t-test mbi ndryshimin midis të dhënave për dy vite tregojnë një nivel sinjifikance në 5%


Mbetet në nivele të ulëta megjithëse me rritje të lehtë vlerësimi për mbështetjen logjistike të inspektorit nga institucionet përkatëse. Megjithëse në përmirësim, sërish ka diskutim mbi përgatitjen profesionale ku ka rritje në vlerësimin ekstrem “shumë jo profesional”.

# III. Kontrolli Tatimor - Vlerësim mbi Qartësinë e Raportit të Kontrollit Tatimor - 2017



Në përgjithësi vihet re një tendencë vlerësimi e lartë për qartësinë e raportit në tërë elementët e konsideruar. Ka luhatje në kategorinë e vlerësimeve shumë i paqartë dhe disi i qartë ku dallohet konsiderueshëm tek “përmbajtja e raportit” dhe “gjetjet/përfundimet”.

# III. Kontrolli Tatimor - Vlerësim krahasimor mbi Qartësinë e Raportit të Kontrollit Tatimor



Në mesatare ka përmirësime të dukshme mbi qartësinë e raportit të kontrollit tatimor në vërtetimin e 2017 kundrejt vërtimit 2015. “Qartësia e raportit” si vlerësim është rritur në të gjithë elementët e konsideruar për raportin e kontrollit (përmbajtja, formati, referencat, gjetjet dhe përfundimet).


## Pra mund te konkludojme :

---

- ▶ **Ndryshim** i natyres se kontrolleve - rritje te nr te kontrolleve, kryesisht tek bizneset mbi 8 milion, POR, me teper **vizita fiskale** dhe vizita ne terren se sa kontrole te plota.
- ▶ Kjo rritje eshte me e ndjeshme ne **sektorin** e Tregtise, nderkohe qe Industria ka nje ulje qe konsolidohet.
- ▶ Rritje te dukshme te vleresimit te **cilesise** se **raportit** te kontrollit, si edhe **sjelljes dhe etikes** se inspektorit.


# III. Rimbursimi i TVSH – Profili, 2017

A keni aplikuar per rimbursim TVSH?



■ PO ■ JO ■ pa pergjigje

Objekti i Rimbursimit te TVSH-se




■ Eksport ■ Investim ■ Tjeter


22% kanë aplikuar për rimbursim TVSH

### III. Rimbursimi i TVSH – Procedura në Rimbursimin e TVSH-së, 2017

A keni perfituar rimbursimin e TVSH-se?




Nese PO keni perfituar:



27 biznese (15 prej tyre eksportues mbi 70%) në vërtetë janë përgjegjës që e kanë marrë rimbursimin e TVSH-së, ndërkohë që 10 deklarojnë rimbursim automatik. Ka një rritje të numrit të rasteve të rimbursuar automatikisht dhe pa kontroll nga sistemi kundrejt vërtetimit të kryer në 2016 (ku u raportuan vetëm 2 raste). Kemi një konsolidim drejt rimbursimit automatik, megjithëse akoma ka nevojë për më shumë raste për ta konfirmuar nga eksportuesit mbi 70%.




## III. Rimbursimi i TVSH – Afatet, 2017




Tek rastet e raportuara nga bizneset që kanë marrë TVSH kemi një respektim afatesh në 52% të rasteve. Ndërkohë që raportohen praktika (5 raste në vërtetim) kur afatet tejkalojnë 90 ditë.

## III. Rimbursimi i TVSH – Krahësim mbi zbatimin e afateve



Zbatimi i afateve mbetet sërish sfidë për administratën tatimore. Megjithatë vërehet një rritje e numrit të rimbursimeve brenda 30 ditëve dhe zvogëlim të numrit të raportuar në afate mbi 90 ditë. Në vërejtje dhe takime direkte bizneset shprehën dhe për kontroll të kryer mbas rimbursimit automatik.

### III. Rimbursimi i TVSH - A ka ndikuar në vendimin për të investuar tek eksportuesit?



Bizneset eksportuese duket se në 2017 janë më pak të ndjeshme në vendimin për të investuar të lidhur me rimbursimin e TVSH-së, kundrejt reagimit që është marrë për këtë kategori në anketën e Sekretariatit në 2016.


## Pra mund te konkludojme qe:

---


- ▶ Ulje të lehte të raportuar të numrit të kompanive që kanë marrë TVSh, por rritje të marrjes në **menyrë automatike**, ose pas **ankimit**.
- ▶ Përmiresim i ndjeshëm i respektimit të afateve të rimbursimit, ku është rritur ndjeshëm nr i rimbursimeve **brenda 30 ditëve por afatet mbeten problematike për palët, akoma raportohen raste që kalojnë 90 ditë.**
- ▶ **Në 2017 eksportuesit kanë ndjerë në mesatare një përmiresim të Afateve të Rimbursimit.**

## Qartësia e informacionit dhe dijeni mbi sistemin e riksut, 2017

Qartësia e informacionit ofruar nga Administrata Tatimore mbi kuadrin ligjor




Dijeni per perzgjedhjen me sistem risku




Bizneset vlerësojnë luhaten në shumicë midis vlerësimit “i qartë” dhe “disi i qartë” për informacionin e ofruar nga administrata tatimore mbi kuadrin ligjor. Ka komente nga bizneset se administrata tatimore në shumë raste kur kërkojnë sqarime për interpretime bënë vetëm citim të akteve ligjore. Ndërkohë, dijenia për zbatimin e sistemit të riskut për përzgjedhjen për kontroll është në nivele të larta.

### III. Marrëdhëniet me Administratën Tatimore – Vlerësim Krahësues mbi Qartësinë e Informacionit




Një përmirësim i ndjeshëm është konstatuar në përgjigjet e bizneseve në lidhje me informacionin e marrë nga Administrata Tatimore. Kjo besojmë se lidhet me përmirësimet në komunikimin dhe shërbimet ndaj tatimpaguesve në periudhën 2016 – 2017.

## Vlerësim krahasues mbi dijeninë e taksapaguesit për zbatimin e sistemit e riskut



Ka një rritje të ndjeshme të dijenisë së taksapaguesve mbi Sistemin e Riskut dhe përzgjedhjen për kontroll në bazë të tij. Kjo mendojmë se i dedikohet dhe me funksionimin e vetë sistemit të riskut dhe informimit që i është bërë taksapaguesve në 2 vitet e fundit.

### III. Marrëdhëniet me Administratën Tatimore – A keni marrë pjesë në seanca trajnimi për bizneset?




Një rritje e lehtë e rasteve të trajnimit raportohet nga bizneset në Vrojtim për 2017, që i përgjigjet dhe një ndërveprimi më pozitiv me Administratën Tatimore. Trajnimet të cilat përmenden më tepër janë mbi raportimet nëpërmjet sistemit elektronik, TVSH, etj.






### III. Marrëdhëniet me Administratën Tatimore – Vlerësim mbi kënaqësinë nga shërbimet elektronike të tatimeve

2017



■ Akresi ne plotesimin elektronik ■ Besueshmeria e te dhenave  
■ Saktesia e perpunimit te te dhenave

2015



■ Akresi në plotësimin elektronik ■ Besueshmëria e të dhënave  
■ Saktësia e përpunimit të të dhënave

**Shënim: rezultatet e t-test mbi ndryshimin midis të dhënave për dy vite tregojnë një nivel sinjifikance në 5%**


Kënaqësia nga shërbimet elektronike të tatimeve është dukshëm më e lartë në 2017 në të tëra aspektet e vlerësuara, si akses, besueshmëria dhe saktësia e përpunimit të të dhënave.

## Pra mund të konkludojme që:

---


- ▶ Kemi një rritje të transparencës dhe komunikimit me binzesin në drejtim të raportit, aksesit në kohë dhe cilësi të informacionit.
- ▶ Mbetet sfidë rritja e njohurive të subjekteve për dinamikën e legjislacionit fiskal.
- ▶ Shumë e rëndesishme që të vazhdoje procesi i digitalizmit të shërbimeve ndaj tatimpaguesve.

### III. Informaliteti – A ndesheni me konkurrencë informale në sektorin ku operoni?



Bizneset duket se kanë përjetuar një rënie të lehtë të konkurrencës nga aktivitetet informale, që gjithsesi mbetet ende perceptuar në nivele të larta dhe shqetësim për ekonominë.


## III. Informaliteti – Natyra e Informalitetit, 2017




Bizneset në vërtetë perceptojnë për 2017 se evazioni fiskal është natyra më e shpeshtë e shfaqjes së informalitetit, e pasuar nga puna në të zezë dhe korrupsioni e kontrabanda. Nga i njëjti vërtetë i kryer në 2015 ka një ndryshim në perceptimin e natyrës si shfaqet informaliteti, ku më i përsërituri ishte korrupsioni/kontrabanda, mosrregjistrim, shmangie taksash e punë në të zezë. Puna në të zezë paraqitet në të njëjtat nivele si në 2015, ndërkohë ka rënë fenomeni i bizneseve të paregjistruara.

# III. Informaliteti – Reagime krahasuese nga biznesi

Kosto apo perfitim




Strategji per tu formalizuar




Bizneset e vlerësojnë në shumicë në të dy periudhat si kosto të qenit informal, vecanërisht në afat të gjatë. Megjithatë edhe pse shprehen që ndeshin konkurrencë informale, pjesa më e madhe nuk pranojnë se kanë informalitet në aktivitetin e tyre.

# III. Informaliteti – Faktorët fiskal më i rëndësishëm që mund të nxisë informalitetin, 2017




Bizneset vlerësojnë në 2017 se nga faktorët fiskalë që lë hapësira për informalitet janë procedurat tatimore, marrëdhëniet me administratën dhe përshkallezimi i tatim fitimit dhe pragu i TVSh. Megjithatë kjo e fundit si shumatore përbën një shqetësim të konsiderueshëm (38%) për bizneset e përgjigjura në vërtetim.

### III. Informaliteti: Shkaqet që nxisin informalitetin, 2017



Në pyetjen e hapur për shkaqet në tërësi që mendojnë se nxisin informalitetin, bizneset perceptojnë se korrupsioni dhe bizneset e lidhura me politikën, pasuar nga kapacitetet e administratës tatimore dhe doganore dhe cilësia e qëndrueshmëria e legjislacionit janë ndër më kryesoret. Del në pah dhe një reagim i biznesit mbi nevojën për përmirësimin e kulturës fiskale nga vetë bizneset për të rritur pajtueshmërinë me sistemin fiskal.

## III. Informaliteti – Propozime për Incentiva, 2017



Përveç kërkesë tradicionale të biznesit për ulje taksash, ka propozim për rritje të bashkëbisedimit me bizneset, përmirësimit të profesionalizimit dhe efijencës së administratës dhe thjeshtimit të procedurave. Ka biznese që kërkojnë të punohet dhe incentivohet konsumatori final për kuponin tatimor



# Konkludojmë se:

---

- ▶ Kemi një perceptim në rënie mbi masën e fenomenit informalitet në krahasim me 2015, ndërkohë që pragu i tatim fitimit/TVSh, marrëdhënia me administratën dhe zbatueshmëria e ligjit mbeten në faktorët kryesore që influencojnë informalitetin.

## IV. Komente nga Biznesi - Rimbursim TVSH

---

- Rimbursim automatik për eksportet dhe shkëmbim informacioni nga doganat kur kryhet eksporti.
- Kreditim automatik te teprices kreditore TVSH.
- Mundësia e sistemit të detyrimeve të tjera me gjendjen e kreditueshme të TVSH-së, si tatim fitimi, tatim mbi qeratë, dividendë apo penalitete, nga sistemi dhe pastaj risku të përcaktojë nëse duhet kontroll apo jo.



## IV. Komente nga Biznesi - Faktorë që cojnë në informalitet

---

- Mungesa e **zinxhirit të faturimit**, blejmë shërbime që nuk janë object TVSH dhe nuk i **shkarkojmë dot TVSH** në blerje, duke qenë se marrim fatura Model 4.
  - **Informalitet** në Turizëm, tek guidat turistike dhe agjensitë e turizimit.
  - Mundësia për të fituar më shumë duke paguar më pak taksa. Fryma e përgjithshme në biznes dhe mungesa e kulturës së biznesi në përgjithësi.
  - Shtysë për konsumatorin final për të tërhequr kuponin tatimor.
  - Nuk ka kontrole ose jane te pamjaftueshme dhe sporadike, dhenia me lehtësi e **licensesave per veprimtari prodhuese**. Ska asnje institucion qe kerkon dhe kontrollon standartizimin e prodhimit dhe respektimin e normave teknike, ambjentale, etj.
  - Heqja e të drejtës për shitje me pakicë (kupon) për biznesin e madh po krijon shoqëri fiktive të shitjes me pakicë, pasi biznesi i madh është i detyruar të krijojë këto shoqëri për të bërë të mundur shkarkimin e mallit që nuk pranon tregu i pakicës. Ky fenomen po bëhet modë dhe duhet gjetur një zgjidhje teknike për të
- 
- ▶ eliminuar zinxhirin e shoqërive fiktive të pakicës.

## IV. Komente nga Biznesi – Incentiva për Formalizim

---

- ▶ Rritja e bonuseve për doganierët nëse rrisin zhdoganimet e rregullta, kështu pjesën që marin nën dorë do e marrin zyrtarisht bonus nga shteti.
- ▶ Kërkesë të origjinës së produkteve në subjektet e tregtimit përfundimtar të produktit.
- ▶ Ideja që një biznes që plotëson kriteret të certifikohet me një pullë dhe kështu inspektorët nuk mund të vijnë e të bëjnë presion cdo javë.
- ▶ Menyra më e mirë për të luftuar informalitetin është të kontrollohen dhe gjobiten qytetaret apo bizneset që nuk pranojnë t'u japësh fature me TVSH.
- ▶ Mundësi sistemimi detyrimesh tatimore pa efekte të menjëherëshme penalitetesh nga kontrollet tatimore.
- ▶ Ndërgjegjësim i publikut. Të merren incentiva që për cdo kupon tatimor do të rimbursohet 5 – 6 – 10 %.
- ▶ Të gjitha subjektet që prodhojnë, shesin apo kanë aktivitet në fushën e Agrobiznesit të jenë të pajisur me licensat perkatese dhe të jenë objekt i monitorimeve sipas ligjit me qëllim që të jenë të gjithë të barabartë. Kjo sidomos është e theksuar neper rrethe.

## IV. Komente nga Biznesi – Incentiva për formalizim

---

- ▶ Administrata tatimore të organizojë takime të vecanta sipas sektorëve, ku ti drejtojnë drejt formalizimit
- ▶ Nje administrate tatimore te pregatitur, le shume per te deshiruar niveli i militantizmit ne administraten tatimore, te rinj e te vjeter nuk ka rendesi, thjesht perzgjedhja eshte me shume me baza lidhjesh partiake se sa me specializime profesionale. Te rinj sapo te diplomuar ose me max 1-2 vjet eksperience pune nuk mund te jene kurre pjese e departamentit te kontrollit tatimor qe shkojne dhe kontrollojne profesioniste qe kane vite ne kete fushe.
- ▶ Sherbimi per tatim paguesin me i hapur dhe ne kontakt te drejtperdrejte me profesionalistet, te ndihmojne subjektet qe te raportojne sic duhet detyrimet tatimore.
- ▶ Informacioni sa më i aksesueshëm. Ligjet të dalin përpara se të zbatohen bashkë edhe me udhëzimet përkatëse dhe të mos ketë shumë ndryshime të ligjeve.



## V. Konkluzione – Kontrolli Tatimor

| Çështje                               | Gjetje                                                                            | Rekomandim KI-(2015-2016)                                                                                                                                           | Koment                                                                                                                          |
|---------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Natyra e Kontrollit                   | Në rritje nr. vizitave fiskale, inspektime ne terren. Në fokus biznesi i madh.    | Njoftimi paraprak i bizneseve për kryerjen e kontrolleve tatimore.                                                                                                  | Saktësuar afatet në procedurat tatimore.<br><b>Sfidë zbatimi i tyre.</b>                                                        |
| Sektorët sipas sistemit të riskut     | Tregti dhe Sherbime, ne ulje Industri perpunuese                                  | Përcaktime ligjore mbi sistemin e riskut dhe publikimi indikatorëve. Përzgjedhje për kontroll deri në 90% nga Sistemi i Riskut.                                     | Publikuar pjesërisht indikatorët e riskut. Bëhet përzgjedhja sipas sistemit të riskut.<br><b>Raporti i kontrolleve me risk?</b> |
| Profesionalizmi i Inspektorit Tatimor | Përmirësim etika, komunikim. Shqetesim kapacitetet institucionale dhe pergatitja. | Të rritet mbështetja e AT me kapacitete njerëzore, buxhetore dhe logjistike. Caktimi i inspektorëve sipas specifikave sektoriale. Paketa motivuese për inspektorët. | <b>Mbetet sfidë për AT dhe MF.</b>                                                                                              |
| Qartësia e raporteve                  | Në përmirësim përmbajtja, formati, referencat ligjore.                            | Të programohen dhe publikohen programet vjetore të trajnimit të inspektorëve në bashkëpunim me shoqata biznesi, shoqëri konsulence dhe auditimi.                    | <b>Kërkohet intensifikim i komunikimit AT me grupet e interesit të biznesit.</b>                                                |

## V. Konkluzione – Rimbursim TVSH

| Çështje               | Gjetje                                                                                                                                                                                               | Rekomandim KI (2015-2016)                                                                                                                                                                                                                                                                                                                                           | Koment                                                                                                                                                                                                        |
|-----------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Afate dhe Procedura   | <p>1. Përmirësuar respektimi i afateve brenda 30 ditëve. Reduktuar përtej 90 ditë.</p> <p>2. Rritur rastet e rimbursimeve automatike, por ne disa raste raportohet për kontroll pas rimbursimit.</p> | <p>Zbatimi i rimbursimit automatik të TVSH-së:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- për eksportuesit mbi 70% brenda 30 ditëve dhe pa kontroll</li> <li>- për eksportuesit 50%-70% brenda 30 ditëve sipas analizës së riskut;</li> <li>- brenda 60 ditëve për të gjithë tatimpaguesit e tjerë.</li> </ul> <p>Transparente Rregullore e Rimbursimit TVSH.</p> | <p>Kuadri ligjor i konsoliduar dhe i kompletuar bashke me zbatimin e kanalit jeshil në dogana, si masë për nxitjen e eksporteve. <b>Nuk është publikuar ende një Rregullore e Rimbursimit të TVSH-së.</b></p> |
| Mundësi për investime | <p>Bizneset eksportuese ndikohen më pak nga rimbursimi i TVSh në vendimin për të investuar ose jo.</p>                                                                                               | <p>Rimbursim i shpejtë i TVSH për të ndihmuar bizneset eksportuese/investuese me likuiditet.</p>                                                                                                                                                                                                                                                                    | <p><b>Mbetet ende për tu përmirësuar përmbushja e afateve. Vendim-marrja në rimbursim jo e kushtëzuar nga plani buxhetor!</b></p>                                                                             |



## V. Konkluzione – Marrëdhëniet me Administratën

| Çështje                                           | Gjetje                                                                                                                                          | Rekomandim KI (2015-2016)                                                                                                                                                                                       | Koment                                                                                                                                                                        |
|---------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Informim & shërbime elektronike                   | Ka reagime pozitive në lidhje me transparencën e informacionit të ofruar nga AT dhe për aksesin në e-tax.                                       | Të publikohen raportet vjetore të menaxhimit të DPT dhe DAT. Vendimet e DAT duhet të publikohen në mënyrë sistematike. Faqja zyrtare në internet të jetë e aksesueshme edhe në gjuhën angleze. Njoftime pop-up. | Konsolidimi i shërbimeve cilesore ndaj tatimpaguesit. Dixhitalizimi i shërbimeve. Publikimi i raporteve të DPD.<br><b>Funksionimi i DAT?</b>                                  |
| Dijeni mbi procedurat tatimore & sistemi i riskut | Tatimpaguesit janë me të informuar mbi përzgjedhjen e kontrollove në bazë të sistemit të riskut.                                                | Informacion për tatimpaguesit që në momentin e regjistrimit në QKB. Publikimi i indikatorëve të riskut                                                                                                          | Ndërgjegjësim nga AT mbi zbatimin e sistemit të riskut. <b>Sfide: Përditësimi i indikatorëve dhe analizave sektoriale të AT mbi bazën e gjetjeve nga kontrollet tatimore.</b> |
| Trajnime të bizneseve & edukim fiskal.            | Trajnimet vlerësohen të domosdoshme, por mbeten të limituara. Vete bizneset (kryesisht të vegjel) ndjejnë nevojën për rritjen e edukimit fiskal | Të përgatiten manualë të thjeshtë mbi sistemin tatimor dhe sesione informuese kryesisht me biznesin e vogël dhe atë të mesëm.                                                                                   | Seksion pyetje-përgjigje nga AT në ëbsite dhe QKB. <b>Cfarë mund të bëhet më tej? Roli i AT dhe Shoqatave të Biznesit- Bashkepunim i Metejshëm.</b>                           |



# V. Konkluzione – Informaliteti

| Çështje                           | Gjetje                                                                                                                                                                  | Rekomandim KI (2015-2016)                                                                                                                    | Koment                                                                                                                             |
|-----------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Format e informalitetit           | Evazoni fiskal është natyra më e shpeshtë e shfaqjes së informalitetit, ndjekur nga puna në të zezë. Perceptim në ulje për nr. të bizneseve paregjistruara (informale). | Përgatitja dhe miratimi i një strategjie të mirëfilltë kundër ekonomisë informale                                                            | Mungon një Strategji e mirëfilltë si document shtetëror, pavarësisht aksioneve të vazhdueshme                                      |
| Faktorët që çojnë në informalitet | Mbetet ende problematike konkurrenca e pandershme si pasojë e nderthurjes të: korrupsionit/ndikimit politik, kapacitetet administrative, fragmentizim fiskal.           | Rivlerësim dhe analizë e sistemit fiskal aktual. Debati mbi prapun e TVSh-se, tatim fitim, incentiva për formalizim.                         | Vazhdon të jetë problem <b>pragu i TVSh dhe tatim fitimi</b> dhe ka një diskutim të hapur midis ekspertëve lidhur me këtë çështje. |
| Incentiva për Formalizim          | Përveç uljes së taksave, propozohet partneritet me biznesin, rritje e efikasitetit të administratës dhe thjeshtimi i burokracive.                                       | Sistem rregullator i thjeshtë/lehtësim i barrës administrative. Rritja e aksesit në shërbimet e transaksionet bankare. Grante për bujqësinë. | <b>Reforma derregullimi?</b><br><b>Incentiva për investime?</b>                                                                    |
| Ndërgjegjësim                     | Përfitim në afat të shkurtër, kosto në afat të gjatë. <u>Shumica shprehen se nuk kanë informalitet.</u>                                                                 | Konsultim , transparencë dhe edukim. Vlerësim publik bizneset e rregullta                                                                    | Fushata informuese mbi aksionin kundër informalitetit.                                                                             |

---

**FALEMINDERIT !**

[www.investment.com.al](http://www.investment.com.al)

